



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.762/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Safa - Gillogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Faton Xhaqkaj, duke vendosur lidhur me apelin e Lahi Ibrahimaj, kandidat për deputet nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), i paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet 0807-03R, 0815C-02R, 0809C-01R, 0107C-01R, 0230-01-D, 0203X-03R, , 0221C-01R, 0232C-02D, 0226C dhe 0216C-02R, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.03.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet** i bazuar apeli me numër Anr.762/2021 i datës 05.03.2021, i parashtruar nga Lahi Ibrahimaj, kandidat për deputet nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, i ushtruar kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 14.02.2021.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për deputet nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në vendvotimin: 0807-03R, 0815C-02R, 0809C-01R, 0107C-01R, 0230-01-D, 0203X-03R, 0221C-01R, 0232C-02D, 0226C dhe 0216C-02R.

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kuti në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatin përfundimtar.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 05.03.2021, ka pranuar apelin Anr.762/2021 nga Lahi Ibrahimaj, kandidat për deputet nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me të cilën pretendon se pas numërimit të votave në mënyrë të gabuar votat e kandidatit Lahi Ibrahimaj me numër 22 gabimisht janë shënuar në FRK, tek kandidati Rexhep Kadriu me numër 23. Këto parregullsi kanë ndodhur në vendvotimet 0807-03R, 0815C-02R, 0809C-01R, 0107C-01R, 0230-01-D, 0203X-03R, , 0221C-01R, 0232C-02D, 0226C dhe 0216C-02R. Në këto vendvotime gjatë plotësimit të Formularit të Rezultateve për kandidat (FRK), komisionerët kanë bërë gabim teknik dhe votat e ankuesit janë bartur tek kandidati me nr.22. Prandaj kërkon nga PZAP, që

fletëvotimet e lartpërmendur të rinumërohen. Gjithashtu thekson se vendvotimet të cilat janë rinumëruar nga ana e KQZ-së, janë vërejtur shumë raste kur votat e kandidatit Lahi Ibrahimaj me nr.22 shënuar në FRK gabimisht tek kandidati me numër 23. Kërkon nga PZAP, që të zhvilloj hetime në materialin zgjedhor në QNR, për vendvotimet e atakuar me apel. I propozon PZAP-së që apeli i ushtruar të pranohet si i bazuar dhe të urdhërohet KQZ-ja, që ti numëroj vetëm fletëvotimet për kandidat nga subjekti politik AAK.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

### **Apeli është i bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se Lahi Ibrahimaj, kandidat për deputet nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, ka paraqitur apel Anr.762/2021, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet 0807-03R, 0815C-02R, 0809C-01R, 0107C-01R, 0230-01-D, 0203X-03R, , 0221C-01R, 0232C-02D, 0226C dhe 0216C-02R.

PZAP, pas shqyrtimit të apelit Anr.762/2021, provave të bashkangjitura në apel, erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Lahi Ibrahimaj, kandidat për deputet nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është i bazuar.

Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet fakti se bartja e votave në formularët FPR, është bërë në kundërshtim me gjendjen faktike dhe me pa rregullsi nga ana e komisionerëve të cilët kanë bërë bartjen e këtyre votave. Andaj nga kjo gjendje e tillë faktike paneli vendosi që vendvotimin 0807-03R, 0815C-02R, 0809C-01R, 0107C-01R, 0230-01-D, 0203X-03R, , 0221C-01R, 0232C-02D, 0226C dhe 0216C-02R, sa i përket kandidatëve për deputet nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës të dërgohet në rinumërim.

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si nën pikën I, II dhe III të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët për deputet nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, për vendvotimin e lartcekur, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim ti bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa**

Anr. 762/2021 më datën 06.03.2021.

**Kryesuese e Panelit**

**Kymete Kicaj**

***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes pranimit të këtij vendimi.

